



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.37/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mehmet Ndrecaj kryetar, Delushe Halimi dhe Gani Avdiu anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses F.A. nga fshati ... komuna e Prishtinës, kundër të paditurës “Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale” - Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, për shkak të anulimit vendimeve, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1324/17, të datë 05.11.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.08.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës “Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale” - Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështjet Administrative A.nr. 1324/17 të datës 05.11.2019 **VËRTETOHET**, përveç pjesës për llogaritjen e kamatës e cila **NDRYSHOHET** dhe gjykohet ashtu që **REFUZOHET** si e pabazuar kamata ligjore e llogaritur sikurse për mjetet e afatizuara për një vit.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar A.nr.1324/17, të datës 05.11.2019, në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses F.A. nga fshati ... komuna e Prishtinës dhe janë anuluar vendimet e të paditurës MPMS/DPA nr. 5051665 i datës i datës 04.07.2017 dhe vendimi i organit të shkallës së parë dt. 28.08.2014 dhe paditëses i është njohur e drejta në pension të personave me aftësi të kufizuar të përhershme nga data 22.05.2014 deri më datën 04.07.2017, në shumën prej 75 euro.

Në pikën II të dispozitivit është detyruar e paditura që paditëses t'ja kompensoj në mënyrë retroaktive pagesën në emër të pensionit për personat me aftësi të kufizuara për periudhën prej datës 22.05.2014 deri më 04.07.2017, gjithashtu edhe kamatën sikurse për mjetet e afatizuara për një vit pa destinim të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Në pikën III të dispozitivit ky aktgjykimi i zëvendëson aktet e anuluar.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Apelit t'a aprovoj ankesën si të bazuar, dhe ta prish aktgjykimin e goditur me ankesë dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe vlerësimit komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të zbatueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se: Ankesa e të paditurës është pa-**bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështjet Administrative, më datën 07.08.2017, ka paraqitur padi për anulimin e vendimit -aktit administrativ të paditurës "Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale" nr. 5051665 të datës 04.07.2017 me të cilin vendim i është refuzuar ankesa e paditëses për njohjen e pensionit të personit me aftësi të kufizuara të përhershme. Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, me aktgjykimin A.nr. 1324/17 të datës 05.11.2019 e ka aprovuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses (si në dispozitiv të këtij aktgjykimit). Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ndër tjerash ka konstatuar se: nga provat e administruara raportet mjekësore të paditëses, nga vendimi i të paditurës me të cilën paditëses i është njohur kjo e drejtë në pension për personat me paaftësi të kufizuara për disa vite por që më pastaj i është ndërprerë, e në veçanti nga ekspertiza mjekësore të nxjerrë nga gjykata e datë 15.08.2019 në përbërje prej tre anëtarëve specialist të fushave përkatëse të QKUK -së është konstatuar se personi në fjalë është person me aftësi të kufizuara të përhershme për punë, dhe shkalla e paaftësisë kalon mbi 69.7 % dhe gjykata ia fali besimin kësaj prove dhe provave tjera raporteve mjekësore të administruara në shqyrtimin kryesor ku është ardhur në përfundim se paditësja është me paaftësi të përhershme të kufizuara në shkallën e paaftësisë 95 %, dhe të njëjtës i njihet e drejta e pensionit në pajtim me Ligjin Për Skemat Pensionale të Financuara nga shteti, përkatësisht nenit 9 par. 1 dhe 5 ku përcaktohet se:

“pensioni i paaftësisë së përhershme do t’ju ofroj mbështetje të financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim, një person do të konsiderohet me pa aftësi të kufizuar të përhershme nëse ofron dëshmi se është me pa aftësi të përhershme para se të aplikoj për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore dhe se komisioni vlerëson se ekziston pa aftësi e përhershme e punës së parashtruesit të kërkesës dhe kohëzgjatjen për periudhën një (1), tre (3) dhe pesë (5) vitesh, dhe pas kësaj periudhe personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor. Në këtë drejtim Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike, në procedurën gjyqësore kishte administruar një mori provash materiale si në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Në par. 2 të këtij po këtij neni është përcaktuar se : *“pensioni i paaftësisë së përhershme do tu paguhet të gjithë atyre personave që janë shtetas të R së Kosovës, që posedojnë dokumentet e identifikimit dhe të cilët i kanë mbushur 65 vjeç”*

Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë - Departamenti për Çështjet Administrative është bazuar të nenit 43.3, 46.2 lidhur me nenet 5, 6, 38 dhe 67 të LKA -së.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar më ankesë në pjesën vërtetuese nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 pika n), ku përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, e sidomos në qoftë se dispozitivi është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të janë treguar fare arsye për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtjen e dokumentit ose procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vetë atyre dokumenteve ose të procesverbalit”* e as nenit 194 të LPK -së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimet e ankuesit se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës, dhe se ka zbatuar në mënyrë jo të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike nuk qëndrojnë sepse aktgjykimi i ankimuar nuk ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet e në lidhshmëri me këtë as dispozitivi i aktgjykimit nuk është kontradiktor në raport me arsyet e aktgjykimit. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat kanë përcaktuar edhe vendosjen meritore të kërkesëpadsisë, prandaj Gjykata e Apelit, nuk është lëshuar në arsyetim të mëtejme pasi që nuk ka mundur të supozoj se cilat janë pretendimet konkrete të ankuesit. Përkritazi me pretendimet e ankuesit për shkelje për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, duke i provuar kështu të gjitha faktet vendimtare të çështjes me çka ka krijuar një figurë të qartë të gjendjes faktike nga e cila pastaj në përputhje me normat e të drejtës materiale ka nxjerrë përfundimin për themelësinë e kërkesëpadisë. Nga shkresat e lëndës konstatohet disa fakte të çështjes kanë qenë jokontestuese, sa i përket asaj që paditësja ka qenë përfituese e pensionit të personit me paaftësi të kufizuar, por kontestuese ka qenë në mes palëve ndërprerja e pensionit ku paditësaj pretendon që i është ndërprerë pa bazë juridike.

Në këtë kontekst gjykata e shkallës e parë me provat e administruara respektivisht nga ekspertiza e ekspertëve mjekësor është konstatuar se paditësi është me paaftësi të përhershme të kufizuar dhe ka sqaruar faktet vendimtare të çështjes në mënyrë të kujdesshme duke dhënë vlerësime adekuate për fuqinë provuese të secilës provë dhe rrjedhimisht të secilit fakt për mënyrën se si gjykata i ka kualifikuar në raport me normën materialo-juridike. E drejta materiale në pjesën vërtetuese të akgjykimit është zbatuar në mënyrë të drejtë nga gjykata e shkallës e parë, dhe në këtë pikë Gjykata e Apelit e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm përfundimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi sipas nenit 20 të Ligjin Për Skemat Pensionale të Financuara nga shteti është përcaktuar që të gjitha pensionet që paguhen sipas këtij ligji, do të fillojnë të paguhen nga dita e parashtrimit të kërkesës, dhe se me vendimin e të paditurës i është refuzuar paditësit kërkesa për njohjen e pensionit të personave me paaftësi të kufizuar, dhe se me të drejtë e paditura është obliguar nga Gjykata e shkallës së parë që në mënyrë retroaktive të paguaj paditësit pensionin nga data e refuzimit të kërkesës apo të ndërprerjes së pagesës së pensionit. Me Ligjin Për Skemat Pensionale të Financuara nga shteti, përkatësisht nenit 9 par. 1 dhe 5 përcaktohet se “pensioni i paaftësisë së përhershme do t’ju ofroj mbështetje të financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim, një person do të konsiderohet me pa aftësi të kufizuar të përhershme nëse ofron dëshmi se është me pa aftësi të përhershme para se të aplikoj për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore dhe se komisioni vlerëson se ekziston pa aftësi e përhershme e punës së parashtruesit të kërkesës dhe kohëzgjatjen për periudhën një **(1), tre (3) dhe pesë (5) vitesh**, dhe pas kësaj periudhe personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor, mirëpo paditësja më datën 26.03.2020 ka dalur në pension të moshës kështu që kompensimin për pensionin për personat me aftësi të kufizuar do ta marrë në mënyrë retroaktive për 7 vite, pasiqë e paditura pa bazë ia kishte ndërprerë.

Gjykata e Apelit nuk e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, në pjesën ku është llogaritur kamata ligjore për arsye se aktgjykimi në këtë pjesë është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n), dhe o), dhe neni 202 i Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore dhe është marrë me shkelje të së drejtës materiale për të cilën gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare nga neni 194 të LKP -së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së. Kjo për faktin se i njëjti është kontradiktor si dhe i mungojnë arsyet lidhur me faktet vendimtare mbi të cilat gjykata është bazuar kur e ka marrë aktgjykimin në fjalë në këtë pjesë, në petitumin e padisë të dorëzuar në Gjykatë me datë 07.08.2017 paditësja nuk ka kërkuar kamatën. Ndërsa Gjykata e shkallës së parë në dispozitivin e Aktgjykimit të ankimuar në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ndër të tjera ka vendosur edhe për kamatën ligjore.

Gjykata e Apelit konstaton se me caktimin e kamatës nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur brenda kërkesëpadisë të parashtruar nga paditësja, pasi që as në petitumin e padisë të dorëzuar në Gjykatë, po ashtu as në seancat e shqyrtimit kryesor, askund nuk përmendet që paditësja ka kërkuar kamatën, pra ka bërë tejkalim të kërkesës.

Në nenin 2.1 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, në mënyrë decisive thuhet se: *“Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse.”*

Gjykata e Apelit konstaton së gjykata e shkallës së parë përfundimin e **tërë kësaj procedure** e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme sa i përket rrethanave që kanë ndikuar në aprovimin e padisë, përveq caktimit të kamatës e cila u dashtë që dispozitivi i aktgjykimit në këtë pjesë të ndryshohet sipas detyrës zyrtare dhe të refuzohet pjesa që ka të bëjë me kamatën. Përfundimisht, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 195 par. 1 pika (d) dhe (e) të LPK-së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.37/20, datë 06.08.2021

Kryetari i kolegjit- Gjyqtari,
Mehmet Ndrecaj